



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1563/6 prot

Datë 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 757/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar/Marreveshje kuader”, me Nr. REF-81211-04-07-2026, me objekt: “Blerje pjese kembimi , lubrifikant (vajra) dhe goma e bateri per mirembajtje ne funksionim te mjeteve te institucionit, Bashkia Diber 2026”, me fond limit 5,492,000(pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH e ndarë ne 3 lote, “Loti I: Blerje pjesë këmbimi”, me REF-81213-04-07-2026, me fond limit 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lek pa TVSH, zhvilluar më datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Diber

Ankimues: Operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK me Nipt M51624039U dhe adresë: Bulevardi Shqiperia e Re, Pallatet Agimi, Shkalla 25, Ap. 399/2, Kati 4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Diber
Bulevardi, ”Elez Isufi”, Peshkopi

.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nwn kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II. 1. Në datën 08.04.2026 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar/Marreveshje kuader”, me Nr. REF-81211-04-07-2026, me objekt: “Blerje pjese kembimi , lubrifikant (vajra) dhe goma e bateri per mirembajtje ne funksionim te mjeteve te institucionit, Bashkia Diber 2026”, me fond limit 5,492,000(pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH e ndarë ne 3 lote, “Loti I: Blerje pjesë këmbimi”, me REF-81213-04-07-2026, me fond limit 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lek pa TVSH, zhvilluar më datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër

II.1. Në datën 29.04.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 07.05.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “KEJ Group” SHPK	1.875.400	lekë	s’kualifikuar
2. “Skyline SC” SHPK	2.125.175	lekë	s’kualifikuar
3. DEGERT AUTO”SHA	2.310.000	lekë	kualifikuar
4. “Mobil Group” SHPK	2.450.000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 07.05.2026 operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

“•Skyline SC nuk ploteson piken 2.3.1 a Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent public dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara pasi i mungon vërtetimi i realizimit nga enti publik..”.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 15.05.2026 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraparak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 22.05.2026 autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e fituesit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe me hapat e mëtejshëm.

II.7. Në datën 19.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6684 datë 19.05.2026 dhe me nr.1563 prot., datë 20.05.2026 e operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar/Marreveshje kuader”, me Nr. REF-81211-04-07-2026, me objekt: “Blerje pjese kembimi , lubrifikant (vajra) dhe goma e bateri per mirembajtje ne funksionim te mjeteve te institucionit, Bashkia Diber 2026”, me fond limit 5,492,000(pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH e ndarë ne 3 lote, “Loti I: Blerje pjesë këmbimi”, me REF-81213-04-07-2026, me fond limit 2,500,000,(dy milion e pesëqind mijë) ë) Lek pa TVSH, zhvilluar më datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Diber.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me

vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Skyline SC” SHPK me pretendimet si vijon:

Kundërshtojmë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i cili ka skualifikuar ofertën ekonomike të paraqitur nga ana jonë për arsye të mos përmbushjes së kritërit Teknik të kualifikimit, pika 2.3.1 në të cilën kërkohet që për vërtetim të realizimeve me sukses të kontratave të ngjashme të mëparshme të paraqesim kontrate/a dhe vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes .

Gjithashtu, lëshimi i faturës tatimore vërteton përfundimin me sukses të kontratës. Përmbushja e një kontrate përfundon me pranimin e faturës tatimore nga AK, i cili me anë të kësaj të fundit pranon realizimin me sukses të kontratës dhe furnizimin sipas kushteve të saj.[...]

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1563/1 prot., datë 20.05.2026 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1563/2026 prot, datë 20.05.2026.

II.9. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka dhënë informacion lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 1562/2 prot., datë 01.06.2026 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.11. Me shkresën nr.2382 prot., datë 03.06.2026 Me objekt “ Dërgohen vendimet e datës 02.03.2026, lidhur me shqyrtimin e Formularit të Ankesave të Operatorit ekonomik Skyline SC”, protokolluar me tonën me nr. 1563/3 prot datë 05.06.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, Vendimin e KSHA-së nr. 1 , datë 02.06.2026. Referuar këtij vendimi rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, Skyline SC” SHPK dhe në përfundim ka vendosur mos pranim të saj.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Skyline SC nuk ploteson piken 2.3.1 a Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara pasi i mungon vërtetimi i realizimit nga enti publik.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” LOTI III, pika 2. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt- ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në vlerë jo më e vogël se 20% nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.1.a Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

2.3.1.b Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.1.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Preventiv për pjesë kembimi 2026 LOTI I

	Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte
	1	Autoveture Benz(Drejtorja e buqesise)				
	1	Filter ajri	Cope	1		
	2	Filter nafte	Cope	1		

3	Filter vaji	Cope	1		
4	Pinjon Motorino	Cope	1		
5	Gomina	Cope	4		
6	kompletim me llampa set	Cope	1		
7	Rip dinamo	Cope	2		
8	Defer	Cope	1		
9	Ferota te pasme	kompl	1		
10	Koka paraleli	Cope	2		
11	Termostat	Cope	1		
	Shuma				
2	JCB 3CX Nr.shasise 3CX97TA . Viti i prodhimit 1999				
1	Filter ajri	Cope	2		
2	Filter nafte	Cope	2		
3	Filter vaji	Cope	1		
4	Filter kambioje	Cope	1		
5	Tubo presioni hidraulike	MI	10		
6	Rekorde	cope	8		
7	Pomp uji	Cope	1		
8	Premistopa te biges	set	1		
9	Fener e drites se punes	cope	2		
	Shuma				
3	Benz SPRINTER 212 Nr.shasise WDB9024611P742504 . Viti i prodhimit 1997				
1	Filter ajri	cope	1		
2	Filter nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Gomina balestre	cope	4		
5	Termostat	cope	1		
6	Defer	cope	1		
7	Ferota para+pasme	kompl	2		
8	Gomina krahu	cope	4		
9	Kapak te pompa e ujit	cope	1		
10	Tensionus ripi	set	1		

11	Fije balestre	cope	1		
	Shuma				
4	Iveco 180E30 Nr.shasie ZCFA1TMH004183182 . Viti i prodhimit 1996				
1	Filter ajri	cope	1		
2	Filter nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Disk Freksioni	cope	1		
5	Sofjeta frenave dores	cope	2		
6	Gjenerator per presionin e ujit per autobotin	cope	1		
7	Balestra	cope	2		
	Shuma				
5	Benz autovinc 814 Nr.shasie WDB6740121K001063 . Viti i prodhimit 1993				
1	Filter ajri	cope	2		
2	Filter Nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Manjet motorinoje	cope	1		
5	Kryq trasmissioni	Cope	1		
6	Radiator uji	Cope	1		
7	Amortizatore	Cope	2		
8	Dinamo	cope	1		
9	Sinjale	set	1		
10	Korona vinxhit (qe kryen levizjen e vinxhit)	cope	1		
11	Kaseta qendrore e vinxhit(e sistemit elektrik)	cope	1		
	Shuma				
6	Ford TORNEO Nr.shasie WFOCXXTTFC4S82754 . Viti i prodhimit 2004				
1	Filter ajri	cope	1		
2	Filter Nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Koka paraleli	cope	2		
5	Koka zbare	cope	2		
6	Fishek temperature	cope	1		
	Kuzhinete qendrore	Cope	1		

7	Fshirse xhami	cope	2		
8	Ferota te pasme dhe para	kompl	2		
9	Sinjale/ llampa	set	1		
10	Amortizatore	cope	4		
11	Gomina balancuesi	cope	4		
	Shuma				
7	Iveco 100E21 Nr.shasie ZCFA1AF12024994618 . Viti i prodhimit 2006				
1	Filter ajri	cope	3		
2	Filter Nafte	cope	2		
3	Filter vaji	cope	2		
4	Tuba hidrauliku	MI	12		
5	Rekorde	cope	16		
6	Premistop Pistoncina	set	2		
7	Muzo	cope	2		
8	Elektrovalvula hidraulike	cope	4		
9	Siguresa	kompl	3		
10	Vlvul sigurise ajrit	cope	1		
11	Sofjeta frena dore	cope	2		
12	Riparim kambio malore-fushore	cope	1		
13	Valv frena dore	cope	1		
14	Guzhinet qendrore	cope	1		
15	Depozite alkoli frenash	cope	1		
16	Centrik	cope	4		
17	Valv frena kembe	cope	1		
18	Ferota para	Komlete	1		
19	Ferota pasme	Komlete	1		
20	Pomp frenash	cope	1		
21	Amortizatore te pare	cope	2		
22	Cilinder frenash	cope	1		
	Shuma				
8	Eskavator VOLVO Nr.shasise VCEC220DJ00280415 . Viti prodhimit 2016				
1	Filter ajri	cope	2		

	2	Filter nafte	cope	2		
	3	Filter vaji	cope	2		
	4	Filter hidrauliku	cope	2		
	5	Filter kondicioneri	cope	2		
	6	Motorino	cope	1		
	7	Radiator uji	cope	1		
	8	Xhami pare	cope	1		
	9	Rula Zinxhiri	cope	4		
	10	Kondicioner rriparim	cope	1		
	11	Sebrentine	cope	1		
		Shuma				
9	Kamion Benz 817 Nr.shasise WDB6763671K320762 . Viti i prodhimit 1998					
	1	Filter ajri	cope	2		
	2	Filter nafte	cope	2		
	3	Filter vaji	cope	2		
	4	Kushinet qendrore	cope	1		
	5	Grupi i timonit	cope	1		
	6	Rrip motorri	cope	1		
	7	Amortizatore	cope	4		
	8	Volant	cope	1		
	9	Gomina te kraheve	cope	2		
	10	Koka paraleli I brendshem	cope	2		
	11	Transmission	cope	1		
	12	Pinjon Motorino+kandeleta	cope	1		
	13	Kryq trasmissioni	cope	1		
	14	Moco krahut djatht	kompl	1		
	15	Kembe motorri	cope	2		
	16	Ferrote para dhe pas	kompl	2		
	17	Muzo	cope	2		
	18	Grup balestre	kompl	1		
		Shuma				
10	TOYOTA RAV 4 Nr.shasise JTEHG20V006075408 . Viti i prodhimit 2005					

1	Filter nafte	cope	1		
2	Filter vaji	cope	1		
3	Filter ajri	cope	1		
4	Amortizatore	cope	2		
5	Kit freksioni	cope	1		
6	Ferota para+ pasme	kompl	2		
7	Gomina shpatulle	cope	2		
8	Fshirse xhami	cope	2		
9	Rrip dinamo	cope	1		
10	Koka paraleli	cope	2		
	Shuma				
11	TOYOTA HI-LUX				
1	Filter ajri	cope	1		
2	Filter nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Ferota te pasme	cope	2		
5	Gomina balancuesi	cope	4		
6	Rrip motorri	cope	1		
7	Amortizatore	cope	2		
8	Pinjon motorino	cope	1		
9	Llampa sinjalesh	cope	4		
10	Koka zbare	cope	2		
11	Termostat	cope	1		
	Shuma				
12	Mercedes Benz 639 Vito 115 CDI (Policia bashkiake)				
1	Filter ajri	cope	1		
2	Filter nafte	cope	1		
3	Filter vaji	cope	1		
4	Rrip motorri	cope	1		
5	Stabizator prapa	cope	2		
6	Ferota te para	kompl	1		
7	Filter kondicioneri	cope	1		
8	Amortizatore te prapa	cope	2		

9	Tub interkul i sperm	cope	1		
10	Gomina stabilizatoresh	cope	4		
11	Pulexho dinamo	cope	1		
	Shuma				
13	Mercedes benz ML 350				
1	Filter ajri	set	1		
2	Filter nafte	cope	2		
3	Filter kondicioneri	cope	2		
4	Filter Vaji	cope	2		
5	Filter kondicioneri i brendshem	cope	1		
6	Tambure te para	cope	2		
7	Ferota para	pale	1		
8	Ferota prapa	pale	1		
9	Jastek ajri	cope	1		
10	Disku I tambureve	cope	1		
11	Sofjete ajri	cope	1		
12	Rrip motorri	cope	1		
13	Pulexho dinamo	cope	1		
14	Tencionus	cope	1		
15	Kavo e frenave te dores	cope	1		
	Shuma				
14	Mak. Teknologjik Isuzu				
1	Filter nafte	cope	2		
2	Filter Vaji	cope	2		
3	Filter Ajri	cope	2		
4	Filter hidrauliku	cope	1		
5	Rekorde	cope	16		
6	Tuba hidrauliku	ml	8		
7	Ferota pasme	kompl	1		
8	Amortizator	cope	2		
9	Gomina balestre	cope	4		
10	Ferota para	kompl	1		
11	Sofjeta e frenave te dores	cope	2		

12	Valvul frenash	cope	1		
13	Disk Freksioni	cope	1		
14	Sinjale llampa	set	1		
15	Specidisk Freksioni	Cope	1		
	Shuma				
15	Miubishi pajera				
1	Filter nafte	cope	1		
2	Filter vaji	cope	1		
3	Filter Ajri	cope	1		
4	Rrip motorri	cope	1		
5	Gomina Ballancuesi	cope	8		
6	Amortizator	cope	2		
7	Koka zbare	cope	2		
8	Koka paraleli	cope	1		
	Shuma				
16	IVECO 150 E18 Viti i prodhimit 1993				
1	Filtra nafte (FRAM-4183-P8043)	cope	3		
2	Filter vaji Iveco (UFI 351)	cope	2		
3	Filter ajri (CA-32-77) (Ø10,Ø21.30cm)	cope	1		
4	Ferrotta per gomat e para dhe te pasme	pale	4		
5	Koke paraleli	cope	2		
6	Gomina balancuesi 45/85	cope	4		
7	Gomina balestre	cope	4		
8	Kryq transmisioni te pompes centrifugale	cope	4		
9	Gomina kembe gabine	cope	4		
10	Gomina amortizatoresh	cope	4		
11	Kuzhinet e trasmesionit	cope	1		
12	Kryq transmisioni	cope	1		
13	Gomina tiranti	cope	2		
14	Koke paraleli timoni	cope	1		
15	Pinjon Motorino	cope	1		
	Shuma				
17	VOLVO F613 Viti i prodhimit 1979				

1	Filtra nafte F713 (FS F0073)	cope	1		
2	Filter vaji F713 (SM40 SCC)	cope	1		
3	Filter ajri F713,PUR FLUKS A169D (32*24*10)	cope	1		
4	Ferota goma te para e te pasme	pale	4		
5	Gomina balancuesi	cope	4		
6	Saborator nafte	cope	1		
7	Koke paraleli	cope	4		
8	Gomina balestre+krahash	cope	4		
9	Amortizatore i gabines volvos	cope	1		
10	Gomina kembe motori	cope	3		
11	Gomina te amortizatoreve	cope	4		
12	Pinjon motorinoje	cope	1		
	Shuma				
18	LAND ROVER DEFENDER				
1	Filter nafte	cope	1		
2	Filer Vaji	cope	1		
3	Filter ajri	cope	1		
4	Ferota frena dore	cope	2		
5	Koke paraleli	cope	2		
6	Kuzhinet qendrore	cope	2		
7	Gomina amortizatori	cope	4		
8	Gomina balancuesi	cope	4		
9	Gomina stabizatori	cope	2		
	Shuma				
	TOTALI PA TVSH				
	TVSH	20%			
	TOTALI ME TVSH				

Afatet e lëvrimit: Lëvrimi i mallrave, është sipas kërkesave të AK duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Ky lëvrim do të kryhet me mjetet e operatorit ekonomik fitues në adresën e Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore nr. 19/2025, datë 18.08.2025, me vlerë 735,000 lekë pa tvsh lëshuar nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK në emër të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Emigracionit.
- Faturë tatimore nr. 5/2025, datë 26.05.2025, me vlerë 169,000 lekë pa tvsh lëshuar nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK në emër të Spitali “Omer Nishani”
- Faturë tatimore nr. 22/2025, datë 01.09.2025, me vlerë 438,999.17 lekë pa tvsh lëshuar nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK në emër të Repartit Ushtarak 4030

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë

teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

1. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës

së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.1. *Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në vlerë jo më e vogël se 20% nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.1.a *Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Ose

2.3.1.b *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik "Skyline" SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt ankimi. Kështu, referuar shtojcës 2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me pjesë këmbimi për automjete. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" është parashikuar se: "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga

autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Lidhur me faktin nëse faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar specifikisht që *Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore lëshuar nga tre ente publike por jo të shoqëruar me kontratën dhe vërtetimin përkatës të realizimit me sukses të këtyre kontratave duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme të ngjashme përcaktuar në pikën 2.3.1 a të kapacitetit teknik.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në rast se operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të

paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Skyline” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me vijimin e autoriteteit kontraktor me hapat e mëtejshëm të zhvillimit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se,

III.2.1. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.2.2. Në rastin konkret, KPP referuar verifikimit të sistemit elektronik SPE rezulton se AK

[illegible]

Gjithashtu referuar pikës 2, të nenit 112, “Veprimet paraprake” të ligjit 162/2020 të Ligjit të Prokurimit publik, i ndryshuar përcaktohet se:

“1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.2.4 Referuar nenit 119 “Pavlefshmëria e kontratave” të ligjit nr. 162/2020 Ligji

b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;

d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

III.2.6 KPP vlerëson se referuar rastit konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedures, pas verifikimit të sistemit elektronik si në vijim :

[illegible]

20

marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në kushtet ku autoriteti kontraktor ka vijuar më konfirmimin e njoftimit të fituesit autoriteti kontraktor është në shkelje të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.2.7. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij dhe mosveprimet, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke mos zbatuar parashikimet ligjore të sipërcituara në III.2. 1 të këtij vendimi si dhe duke mos zbatuar rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot. Datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit”.

III.2.8 Duke marrë shkas nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga verifikimi i sitemit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi ka vijuar me hapat procedural duke mos pezulluar procedurën e prokurimit edhe pse ishte paraqitur ankese lidhur me procedurën objekt shqyrtimi. Për sa më sipër parashtruar, Komisioni i Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për të gjithë zyrtarët përgjegjës për shkeljet e konstatuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Skyline” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar/Marreveshje kuader”, me Nr. REF-81211-04-07-2026, me objekt: “Blerje pjese kembimi , lubrifikant (vajra) dhe goma e bateri per mirembajtje ne funksionim te mjeteve te institucionit, Bashkia Diber 2026”, me fond limit 5,492,000(pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH e ndarë ne 3 lote, “Loti I: Blerje pjesë këmbimi”, me REF-81213-04-07-2026, me fond limit 2,500,000,(dy milion e pesëqind mijë) ë) Lek pa TVSH, zhvilluar më datë 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Skyline” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

